
	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	
---	--	---

Datë/a:	07.08.2019
Për/ Za/ To:	N.T.P. "Vlora"-Prishtine
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 02.08.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "N.T.P."VLORA" lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me rekuizita sportive", me Nr. të Prok: **616-18-860-121**, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik N.T.P."VLORA" të dt. 02.08.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me rekuizita sportive", me Nr. të Prok: **616-18-860-121**, në Njoftimin Vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës 29.07.2019.

1. Autoriteti Kontraktues, do të vazhdojë aktivitetin e prokurimit sipas Vendimit të datës

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 06.08.2019 ka trajtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimet per mos saktesine e vlerave te faturave dhe kontratave te dorezuara jane te drejtuara ne adrese te gabuar pasi qe kjo eshte ne pergjegjesine e tenderuesit dhe jo te Autoritetit Kontraktues dhe nese keni deshmi te tilla atehere duhet te drejtoheni te organet e drejtesise;

-Pretendimet tjera lidhur me fatura fiktive e formulime tjera poashtu nuk jane ne kompetencen tone,pasiqe komisioni ka pranuar deshmite plotesuese qe i jane kerkuar dhe ka konstatuar se te njejtat jane te pranueshme.Duhet t'ua rikujtojme se sqarimet plotesues jane kerkuar pikerisht ne baze te Vendimit te OSHP-se;

-Kontestimet qe i keni paraqitur lidhur me furnizimet me material zyrtar dhe shkollor,leter dhe produkte te letres etj, per ne jane te mireseardhura,por nuk besoj qe keni harruar se ju keni fituar tender pikerisht ne baze te deshmive te tilla te cilat me Vendimin e OSHP-se ne baze te pretendimeve tuaja ankimore jane pranuar si referenca per paisje sportive e qe per ne kane qene te pa pranueshme si qe jane per ju ne kete rast.Nese keni harruar ua rikujtoj tekstin:referenca-kontrata per furnizim me material shpenzues ne vleren 50.000.00 euro i pranohet pasiqe ne kuader te te njejtës ka edhe material sportiv.E drejte e juaja eshte qe kur jane ne pyetje OE-ik tjere te mendoni ndryshe,por nuk besoj se kete qendrim do ta ndryshoj Organi Shqyrtues i Prokurimit,pasi qe e ka vendosur vete nje praktike te tille.

Ne fund ju sqarojme se AK-ja ka rivleresuar tenderin ne baze te Vednimit te OSHP-se,respektivisht ne harmoni te plote me nenet 1,6 dhe 59 te LPP-ik.

Zyrtari Pergjegjës i prokurimit bazuar ne faktin se pretendimet jane te pa bazuara ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kunder ketij Vendimi mund te parashtrohet ankese ne OSHP ne afat prej dhjete(10)diteve nga dita e pranimi te ketij Vendimi.

Zyrtari pergjegjës i Prokurimit

